



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201600076/5

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda :** *Rekomandim për ndërprerjen e veprimeve të kundërligjshme ndaj shoqërisë tregtare "Brilant" shpk.*

**Drejtuar :** Shefit të Komisarariatit të Policisë nr. 2  
Z. Arsen SINOMATAJ

Tiranë

**Për dijeni :** Drejtorit të Policisë së Shtetit  
Z. Haki ÇAKO

Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë  
Z. Ervin HODAJ

Tiranë

I nderuar zoti Sinomataj,

Sikurse ju kemi vënë në dijeni, në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetësja N.Q., administratore e shoqërisë tregtare "Brilant" shpk. Ankuesja shkruan se, shoqëria tregtare "Brilant" shpk ka si objekt të veprimtarisë së saj ndërtimin e objekteve sociale, etj. Në ushtrim të veprimtarisë së saj, shoqëria ka filluar ndërtimin e një pallati 5 dhe 7 kate, për të cilin ka nxjerrë leje të rregullt ndërtimi, vendimi nr. 1137/2, datë 07.02.2014 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe leja zhvillimore nr. 1137/5, datë 16.05.2014.

Pas marrjes së lejes së ndërtimit ka filluar ndërtimin e pallatit 5 dhe 7 katësh. Ndërkohë, mbi këto kate, ka ndërtuar edhe tre kate shtesë pa leje.

Në muajin Janar 2015 ka paraqitur kërkesë për legalizimin e kateve shtesë pa leje në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tiranë nr. 2, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, sepse ishte subjekt përfitues i këtij ligji.

Gjatë kohës që ishte në pritje të legalizimit të tre kateve shtesë, INU Bashkia Tiranë ka nxjerrë disa urdhëra administrativ me objekt prishjen, pezullimin e punimeve dhe gjobë për ndërtimin pa leje të tre kateve.

Tre urdhërat administrativ janë bërë objekt gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kjo gjykatë, me vendimin nr. 5468, datë 30.10.2015, ka bërë anulimin e tyre. Menjëherë sapo vendimi i gjykatës mori formë të prerë, INU Bashkia Tiranë ka përsëritur të njëjtat urdhëra administrativ, duke rritur dyfishin e

gjobës dhe duke urdhëruar përsëri prishjen e shtesës së pallatit. Me kërkesën e ankueses këto urdhëra u kundërshtuan në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me vendimin nr. 4 të regj. them., datë 08.01.2016 ka vendosur pezullimin e akteve administrative të INU Bashkia Tiranë "Për prishje objekti" me nr. 5667, datë 28.12.2015, si dhe nr. 2577, datë 28.12.2015, "Për dënim me gjobë" deri në përfundim të gjykimit.

Bazuar në këto vendime gjyqësore dhe në pritje për tu gjykuar në themel aktet e fundit, shoqëria ka vazhduar punimet në objekt për ta përfunduar atë në afatin e parashikuar në lejen e rregullt zhvillimore.

Sipas ankueses, në mënyrë të papritur dhe të paligjshme, punonjësit e Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë kanë ushtruar presion dhe kryer veprime, duke penguar vazhdimin e punës në këtë objekt. Në datën 16.01.2016, Komisariami i Policisë nr. 2 Tiranë ka ndërhyrë në mënyrë të kundërligjshme në këtë objekt. Forca të shumta të këtij komisariami kanë kërkuar ndërprerjen e punimeve, paraqitjen e punëtorëve në komisariami dhe kanë qëndruar në objekt, duke u shprehur se do ta prishnin atë. Në fund të ditës, kur do të iknin në shtëpi, punëtorët i janë përgjigjur thirrjes së policisë për të shkuar në komisariami për të dhënë shpjegime. Ata pasi janë mbajtur të shoqëruar për disa orë, janë lënë të lirë dhe janë urdhëruar që të mospunonin më në këtë objekt. Ndërkohë, që nga data 16.01.2016 e në vazhdim në objekt qëndrojnë në mënyrë të vazhdueshme punonjës policie, me justifikimin se objekti është një trup i vetëm i "paligjshëm".

Ankuesja pretendon se, policia në mënyrë të kundërligjshme ka filluar hetimin ndaj punëtorëve për veprën penale të kundërshtimit të punonjësve të policisë.

Sipas ankueses, veprimet e policisë për pengimin e punimeve, si në objektin e ndërtuar me leje, ashtu edhe në pjesën e ndërtuar pa leje, si dhe shoqërimin dhe pyetjen e punëtorëve janë të kundërligjshme, jashtë kompetencës së saj ligjore, si dhe vijnë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit".

Gjithashtu ankuesja pretendon se, nga këto veprime të policisë, shoqërisë së saj po i shkaktohet një dëm i konsiderueshëm moral dhe ekonomik për shkak të vonesave të skelave dhe të penaliteteve në bazë të kontratave të lidhura me blerësit. Sipas saj, këto veprime janë të qëllimshme dhe të urdhëruara nga funksionarë të lartë të Policisë së Shtetit. Së bashku me ankesën ankuesja në ka dërguar edhe kopje të vendimeve gjyqësore të cituara më sipër dhe të dokumentave të tjera që lidhen me këtë problem.

Për të mundësuar shqyrtimin e kësaj ankese, me shkresën nr. K2/N2-2 Prot., datë 01.02.2016, ju kërkuam të dërgonit brenda 10 ditëve shpjegime lidhur me këtë ankesë. Ndonëse afati ligjor i kthimit të përgjigjes së shkresës tonë kaloi, ju nuk na e dërguat atë.

Përveç sa më sipër, në datën 16.02.2016 familjarët e ankueses u paraqitën në institucionin tonë dhe na njoftuan se në këtë datë Zyra e Përmbaramit Tiranë ka bërë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të cituara më sipër duke mbajtur edhe procesverbalin përkatës, një kopje të të cilit na e vunë në dispozicion. Sapo është bërë ekzekutimi i vendimeve gjyqësore dhe punonjësit e shoqërisë kanë hyrë në objekt për të vazhduar punimet, aty kanë shkuar dy punonjës të INU Bashkia Tiranë dhe një furgon me disa punonjës policie me uniformë dhe civilë të Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë. Këta të fundit kanë nxjerrë të gjithë punonjësit e shoqërisë jashtë objektit dhe i kanë shoqëruar në komisariami. Gjithashtu ata kanë shoqëruar në komisariami edhe administratoren e shoqërisë shtetasen N.Q. dhe inxhinjerin e zbatimit të punimeve në këtë objekt shtetasin L.Sh..

Ndodhur në këtë situatë dhe për të bërë verifikimet e nevojshme, u dërgua në vend një ndihmëskomisioner i institucionit tonë. Përfaqësuesi ynë mori takim me shefin e seksionit për parandalimin dhe hetimin e krimeve, i cili e informoi se personat e

përmendur më sipër ishin shoqëruar në polici për shkak të kryerjes së veprës penale të ndërtimit të paligjshëm.

Ndërkohë përfaqësuesi ynë mori takim dhe pyeti me procesverbal shtetasen N.Q., administrator e shoqërisë “Brilant” shpk si dhe inxhinjerin e zbatimit të punimeve shtetasin L.Sh.. Të dy këta ishin pyetur me cilësinë e përsëritjes ndaj të cilit zhvillohen hetime për veprat penale respektivisht e para për ndërtim të paligjshëm dhe i dyti për kundërshtimit të punonjësve të INU Bashkia Tiranë dhe të punonjësve të policisë së rendit. Ndërkohë ata pretenduan se shoqërimi dhe pyetja e tyre nga punonjësit e policisë ishin veprime të paligjshme sepse nuk kishin kryer asnjë vepër penale dhe se hyrja në objekt dhe fillimi i punimeve ishin kryer pas ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga Zyra e Përmbartimit Tiranë. Gjithashtu shtetësja N.Q. pretendoi se, këto veprime ndaj saj dhe shoqërisë që ajo drejton ishin bërë me qëllim hakmarrjeje për shkak se ajo para rreth një muaji kishte bërë kallëzim në organin e Prokurorisë Tiranë ndaj Shefit të Komisarariatit dhe disa drejtuesve të tjerë të këtij komisarati për veprën penale të kryerjes së veprimeve arbitrare. Ndërsa shtetasi L.Sh. pretendoi se, gjatë shoqërimit ishte goditur me shqelma nga një punonjës policie civile.

Përfaqësuesi i institucionit tonë bëri verifikime në vend, në objektin e shoqërisë “Brilant” shpk. Nga verifikimi u konstatua se porta e rrethimit të jashtëm të këtij objekti ishte e mbyllur dhe pranë tij qëndronte një patrullë policie e Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë. Punonjësit e policisë e informuan se kishin çelësin e portës hyrëse dhe se ishin ngarkuar me detyrë për të moslejuar kryerjen e punimeve në këtë objekt (pallat).

Nga shqyrtimi i kësaj ankesë dhe i dokumentave të administruara nga institucioni ynë rezultoi se, veprimet e kryera nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë ndaj shoqërisë tregtare “Brilant” shpk, duke e penguar atë që të vazhdojë punimet në objektin në fjalë janë të kundërligjshme.

Nga dokumentacioni i administruar nga ana jonë rezultoi se, punimet në këtë objekt janë pezulluar nga IMT Bashkia Tiranë, i cili ka nxjerrë tre akte administrative respektivisht, nr. 1746, datë 01.06.2015 “Për pezullimin e punimeve”, nr. 2486, datë 01.06.2015 “Për dënimin me gjobë” dhe nr. 5631, datë 01.06.2015 “Për prishje objekti”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 5468, datë 30.10.2015, ka bërë anulimin e tyre. Ky vendim ka marrë formë të prerë.

Megjithëse vendimi i gjykatës mori formë të prerë, IMT Bashkia Tiranë ka nxjerrë dy akte administrative, respektivisht nr. 5667, datë 28.12.2015 “Për prishje objekti” dhe nr. 2577, datë 28.12.2015 “Për dënim me gjobë”.

Me kërkesën e ankueses këto akte administrative u kundërshtuan në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me vendimin “Për sigurim padie” nr. 4 regj. them., datë 08.01.2016 ka vendosur pezullimin e akteve administrative, vendimeve të IMT Bashkia Tiranë, respektivisht, me nr. 5667, datë 28.12.2015 “Për prishje objekti” nr. 2577, datë 28.12.2015, “Për dënim me gjobë” deri në përfundim të gjykimit.

Për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të cituara më sipër, të cilat në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile janë tituj ekzekutiv, shoqëria tregtare “Brilant” shpk i është drejtuar me kërkesë Zyrës Përmbartimore Tiranë. Kjo zyrë në datën 12.02.2016 ka bërë ekzekutimin e tyre duke lejuar futjen në objekt të palës kreditore përfaqësuar nga administratorja shtetësja N.Q. dhe fillimin e punimeve të pezulluara. Për këtë veprim nga përmbartuesi gjyqësor Pjetër Caka është mbajtur edhe procesverbali përkatës i kryerjes së veprimeve përmbartimore gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Bazuar në këto vendime gjyqësore dhe në pritje për tu gjykuar në themel aktet e fundit, shoqëria ka vazhduar punimet në objekt për ta përfunduar atë në afatin e parashikuar në lejen e rregullt zhvillimore.

Ndonëse u bë ekzekutimi i vendimeve gjyqësore konform ligjit, shoqërisë “Brilant” shpk i janë sjellë pengesa të kundërligjshme nga Komisarati i Policisë nr. 2

Tiranë në kryerjen e aktivitetit të ligjshëm për vazhdimin e punimeve për ndërtimin e objektit.

Për shkak të situatës së krijuar, Zyra e Përmbarrimit Tiranë në datën 16.02.2016 është paraqitur në objektin në fjalë dhe ka ribërë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të cituara më sipër, duke futur në objekt punonjësit e shoqërisë “Brilant” shpk për të punuar. Edhe për kryerjen e këtij veprimi nga përmbarruesi gjyqësor Pjetër Caka është mbajtur procesverbali përkatës i kryerjes së veprimeve përmbarrimore gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Mirëpo pa kaluar një orë nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore i kryer nga organi kompetent, Zyra e Përmbarrimit Tiranë, punonjësit e policisë të organit që ju drejtoni kanë ndërhyrë duke u bërë pengesë për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe lëjimin e shoqërisë ndërtuese “Brilant” shpk për të zhvilluar aktivitetin ligjor.

Theksojmë se, vendimi i Gjykatas Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 5468, datë 30.10.2015, i cili ka anuluar aktet administrative të INU Bashkia Tiranë dhe vendimi me regj. them. nr. 4, datë 08.01.2016, i cili ka vendosur pezullimin e akteve administrative, vendimeve të IMT Bashkia Tiranë, respektivisht, me nr. 5667, datë 28.12.2015 “Për prishje objekti” dhe nr. 2577, datë 28.12.2015, “Për dënim me gjobë” deri në përfundim të gjykimit, në bazë të nenit 510/a të Kodit të Procedurës Civile janë tituj ekzekutiv dhe për rrjedhojë ekzekutimi i tyre bëhet edhe me detyrim nëpërmjet Zyrave Përmbarrimore, sikurse është bërë në fakt. Pretendimet dhe argumentat e dhëna nga punonjësit tuaj se, shoqërimi i punonjësve të kësaj shoqërie është bërë sepse kanë bërë ndërtim të paligjshëm nuk qëndrojnë. Gjithashtu edhe pretendimi i bërë nga punonjësit e policisë se, në vendimet gjyqësore gjykata nuk është shprehur për vazhdimin e punimeve në këtë objekt nuk qëndron. Ju sjellim në vëmendje se punimet në objektin që ndërton shoqëria “Brilant” shpk janë pezulluar me aktet administrative të nxjerra nga IMT Bashkia Tiranë. Në rrethanat në të cilat ndodhemi aktualisht, kur këto akte administrative janë anuluar me vendim gjyqësor të formës së prerë në rastin e parë dhe janë pezulluar me vendimin për sigurim e padisë në rastin e dytë, nuk ka asnjë mëdyshje lidhur me të drejtën e shoqërisë për të vazhduar punimet e ndërprera. Përderisa nga organet gjyqësore nuk është marrë ndonjë vendim për pezullimin e ekzekutimit të veprimeve përmbarrimore, ato duhen zbatuar.

Ndërkohë ju sjellim në vëmendje nenin 142/3 të Kushtetutës tonë, në të cilit parashikohet se: *“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”*.

Ndodhur në këto rrethana, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut nga administrata publike”* dhe në nenin 21/b të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*;

### **REKOMANDOJMË:**

1. Ndërprejen e menjëhershme të veprimeve të kundërligjshme të Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë ndaj shoqërisë tregtare “Brilant” shpk dhe lejimin e saj për të ushtruar aktivitetin ndërtues në objektin e ndodhur në Rr. “F. Shiroka”, Tiranë.

2. Marrjen e masave të nevojshme për analizimin e veprimeve jo korrekte dhe sjelljes pa etikë të punonjësve të policisë që kanë kryer veprimet me punonjësit e kësaj shoqërie dhe marrjen e masave të nevojshme ndaj personave përgjegjës.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda 30 ditëve konform nenit 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**

**Në mungesë dhe porosi**

**K O M I S I O N E R I**

**Ermir KAPEDANI**